

SI TË FLASIM ME FËMIJËT NË MOSHËN E HERSHME PËR PARA?

Fëmijët që bisedojnë me prindërit për para, për shpenzimet dhe kursimet janë të prirë të menaxhojnë më mirë me paratë kur të rriten.

Prindërit duhet të bisedojnë me fëmijë rreth rëndësisë së parave sepse biseda krijon vetëbesim te fëmijët dhe ndihmon në zhvillimin e aftësive të tyre financiare.



Edukimi
Financiar



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË MËSOJNË FËMIJËT PËR PARA NË SHKOLLË?

Mësimi i fëmijëve për rëndësinë e parasë do t'iu ndihmojë, që e ardhmja e tyre të jetë më e sigurt.

Sa më herët fëmijët të fillojnë zhvillimin e aftësive të tyre financiare, aq më shpejt do të mund të fillojnë t'i përdorin këto aftësi gjatë jetës së tyre. Fëmijët që kanë njohuri për paratë, në të ardhmen do të jenë të përgjegjshëm dhe do të dinë të marrin vendime të duhura për paratë e tyre.



Edukimi
Financiar



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

FËMIJËT NË MOSHËN PARASHKOLLORE

Në moshën parashkollore, fëmijët mund të mësojnë të njohin monedha të ndryshme nga numrat e vendosur në monedhë, sipas ngjyrës, madhësisë dhe formës së tyre.

Fëmijëve duhet të ju shpjegohet për paranë, që ata të kuptojnë se gjërat kushtojnë shuma të ndryshme parash, të kuptojnë se paratë duhet të ruhen të sigurt, në mënyrë që ata të mos i humbin ato dhe të mbajnë llogari sa para kanë në dispozicion.



Edukimi
Financiar



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

FËMIJËT TRE DHE KATËR VJEÇ MUND TË FILLOJNË TË MËSOJNË RRETH PARASË

Mund të filloni t'iu mësoni fëmijëve të njohin paratë që nga mosha tre dhe katër vjeçare sepse kur fëmijët fillojnë të flasnin dhe të bëjnë pyetje, kur fillojnë të dallojnë gjërat me anë të prekjes dhe të luajnë me gjithçka do të mund të kuptojnë më saktësisht rëndësinë e tyre.

Duke u njohur me paranë ata priren të jenë kurioz për botën dhe rëndësinë e gjërave, e në mesin e tyre edhe paratë.

Fëmijët tre dhe katër vjeç mësojnë më shumë nga të tjerët, p.sh prindërit apo familjarët, leximi i broshurave apo fletushkave të ndryshme përfshirë edhe ndjekjen e programeve televizive.



Edukimi
Financiar



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

MBAJTJA E PARAVE TË SIGURTA

Gjithmonë prindërit duhet të sigurohen që fëmijët kanë një vend të sigurt për t'i ruajtur paratë e tyre.

Ata duhet t'ua shpjegojnë se si është të mbani para të sigurta dhe cila është mënyra më e mirë për t'i siguruar ato.

Duke folur për atë që fëmija juaj mund të blejë me paratë e tyre në të ardhmen, ju mësoni fëmijët se si duhet të fillojnë të kursejnë. Përdorni numërimin për të treguar se si do të shtohen paratë e tyre nëse i kursejnë ato.

Një udhëtim i dëshiruar i fëmijës mund të jetë një inspirim dhe motivim për të kursyer dhe për ta dërguar fëmijën deri te realizimi i dëshirës.




RËNDËSIA E NUMËRIMIT

Paraja ka të bëjë me numrat andaj numërimi është një aftësi e vlefshme për t'i mësuar fëmijët kur i prezantoni ata për herë të parë me paranë, si dhe rëndësinë e tyre.

Kërkoni prej tyre të numërojnë shuma të ndryshme dhe në kohë të ndryshme.

Kur të numërojnë saktë, i shpërbleni.



Edukimi
Financiar



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

FUQIA E LOJËS

Në moshën tre dhe katër vjeçare, fëmijët mësojnë përmes lojës. Më poshtë gjeni disa nga lojërat të cilat do t'iu ndihmojnë t'i mësoni fëmijët rreth rëndësisë së parasë.

KOPJIMI I MONEDHËS

Vendosni monedhën nën një copë letër dhe ngjyrosni butësisht me një laps me ngjyrë mbi të derisa të dalë modeli i monedhës. Kjo është një mënyrë e shkëlqyeshme që fëmijët të mësojnë vlerën e monedhave me forma të ndryshme.

T'I SHIKOJMË DHE T'IU NDIHMOJMË NË BLERJEN

Dyqani ushqimor ku bëni blerjet javore - është një mënyrë e shkëlqyeshme për t'iu treguar fëmijëve se si duhet të menaxhohet me paranë.



Edukimi
Financiar



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PLANIFIKON BLERJET SË BASHKU ME FËMIJËT

Tregojuni fëmijëve se si i planifikoni blerjet tuaja, gjërat që kemi nevojë për to, pastaj gjërat që kemi dëshirë, si dhe sa para kemi shpenzuar e sa na kanë mbetur.

Filloni duke shkruar një listë të ushqimeve që ju duhen kundrejt atyre që dëshironi.

Përderisa ecni nëpër dyqan - nëse ata kërkojnë gjëra që nuk janë në listë, kujtojauni atyre se duhet ta ndjekin listën e bërë sepse vetëm për këtë kemi para.

Kërkojuni atyre të ndihmojnë në gjetjen e artikujve në listë, duke i krahasuar artikujt në bazë të çmimit dhe vlerës. Nëse jeni duke paguar me para të gatshme, kërkonini nga fëmijët t'ia japin arkëtarit paratë. Nëse paguani me kartelë shpjegojauni nga vijnë paratë në kartelë.



FËMIJËT KATËR DHE PESË VJEÇ

Në moshën katër dhe pesë vjeçare fëmijët fillojnë të zhvillojnë kuptimin e thellë të numrave dhe janë në gjendje t'iu kushtojnë vëmendje për më gjatë. Kjo është një moshë e shkëlqyeshme për të kaluar nga loja në të kuptuarit më mirë të gjërave.

Ndihmo fëmijët të mësojnë për të pritur, të dëshirosh është një ndjenjë e madhe dhe e shëndetshme te fëmijët, por për realizim të dëshirave ndonjëherë duhet të presim, mësoju këtë në mënyrën tënde.

Ju mund t'i përdorni këto "dëshira" për t'iu mësuar atyre aftësinë e kursimit, negocioni e flisni me ta se si ndonjëherë ata nuk mund të kenë atë që duan.



Edukimi
Financiar



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLA

Nëse planifikoni të shkoni në një dyqan lodrash diskutoni bashkërisht se çfarë do të bleni dhe pse do të bleni.

DËGJOJINI FËMIJËT TUAJ

Bëjini të ndihen të dëgjuar duke u dhënë mundësi të bëjnë një listë të gjërave që mund të dëshirojnë për ditëlindje ose pushime.

SHPJEGOJAUNI

Në vend që thjesht të thoni jo shpjegojuni pse. Shpjegimi se kemi para vetëm për gjëra që na duhen dhe jo mjaftueshëm për dëshira, i ndihmon ata të kuptojnë zgjedhjet që të rriturit duhet të bëjnë në lidhje me paratë. Qëndroni fjalës tuaj duke iu thënë jo dhe duke iu përmbajtur vendimit tuaj sepse kjo i ndihmon fëmijët të mësojnë vetëkontrollin, të kuptojnë dallimin midis nevojave dhe dëshirave dhe të kursejnë për ato që duan.



Edukimi
Financiar